



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.290/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova, dhe Bujar Muzaqi-anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;03.02.2025, merr këtë,

VE N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.290/2025, e datës;01.02.2025.
- II. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) euro.
- III. Detyrohet subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) , që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë;01.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet në llogarinë zyrtare të Komunës së Obiliqit në facebook është postuar një fotografi, me tekst shoqërues, e cili është realizuar në hapësirat e brendshme në Komunën e Obiliqit, në kundërshtim me dispozitat ligjore zgjedhore, duke shfrytëzuar burimet dhe institucionet publike shtetërore për qëllime elektorale. Më tutje në ankesë pretendohet se shefi i shtabit zgjedhor Ibush Mjekiqi nga radhët e subjektit politik LDK, kishte mbajtur një takim i cili kishte për qëllim organizimin e tubimit zgjedhor të 2 Shkurtit në Komunën e Obiliqit. Andaj në ankesë pretendohet se me këtë veprim subjekti politik LDK ka shkelur dispozitat ligjore të nenit 36, paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-288 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP që të nxjerrë vendim me të cilin do të aprovojë si të bazuar

ankesën e LVV-së, dhe ndaj subjektit politik LDK, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, t'i shqiptojë dënim me legjislacionin në fuqi. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur postimin në facebook me fotografi që dëshmon veprimin në kundërshtim me LZP-në.

Më datë;31.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë;01.02.2025.

Në përgjigjen në ankesë të datës;01.02.2025, të subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka theksuar se në lidhje me ankesën e LVV-së, kanë sqaruar se është bërë një gabim teknik nga administratorja e faqes, lidhur me publikimin e datës 31 Janar 2025, në faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit, e cila aksidentalisht e ka publikuar postimin dhe se i njëjti postim është fshirë brenda sekondave, sapo gabimi është vërejtur dhe nuk ka pasur asnjë qëllim për keqpërdorim të burimeve institucionale për ndonjë aktivitet politik apo elektoral. Më tutje në përgjigje në ankesë theksojnë se ky ishte një gabim teknik i cili nuk mund të keqpërdoret për të ndërtuar narracione të pavërteta dhe se as komuna e Obiliqit dhe se as LDK në Obiliq, nuk kanë as një interes dhe as një praktik që të përdorin asetet publike për qëllime politike. Po ashtu theksojnë se sa u përket pretendimeve se ky postim është bërë për promovim të një aktiviteti elektoral të LDK-së, theksoj se LDK-ja, është një subjekt i përgjegjshëm i cili respekton me përpikëri legjislacionin në fuqi dhe normat demokratike, dhe se të gjitha aktivitetet e saj i zhvillon në përputhje të plot me kornizën ligjore zgjedhore dhe në asnjë rrethanë nuk ka shkelur ndonjë dispozitë për përdorimin e resurseve publike për qëllime politike. Në përgjigjen e tyre theksojnë se Subjekti politik LDK, në Komunën e Obiliqit, do të vazhdojnë të jetë një forcë politike dhe një konkurrencë e hapur politike që promovon zgjedhje të ndershme duke u bazuar në ide dhe vizion për qytetaret. Më tutje përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar nga PZAP që ta refuzojë si të pa bazuar ankesën A.nr.290/2025.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë, vëren se ankesa është e bazuar.

Nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik LVV dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e shefi i shtabit zgjedhor, Ibush Mjekiqi nga radhët e subjektit politik LDK, është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që është shfrytëzuar institucioni publik, këtë rast Komuna nga zyrtari publik për qëllime elektorale, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili nen përcakton se “ *Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave*”.

Edhe pse sipas përgjigjes së dhënë në ankesë pretendohet se është bërë një gabim teknik nga administratorja e faqes, lidhur me publikimin e datës 31 Janar 2025, në faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit, e cila aksidentalisht e ka publikuar postimin dhe se i njëjti postim është fshirë brenda sekondave, sapo gabimi është vërejtur dhe nuk ka pasur asnjë qëllim për keqpërdorim të burimeve institucionale për ndonjë aktivitet politik, mirëpo sipas vlerësimit të panelit në fotografimin e bashkangjitur shihen postera të subjektit politik LDK dhe takimi i

përfaqësuesve të njëjtit subjekt politik brenda zyreve të Komunës së Obiliqit, të udhëhequr nga udhëheqësi i shtabit zgjedhor, Ibush Mjekiqi, për mobilizim gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të përfitimit të votave, mirëpo sipas vlerësimit të panelit ky veprim është në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par.1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se: “ *Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave*”.

Kështu që paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përben shkelje të legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj takimi i mbajtur dhe përfshirja e fotografisë për fushatë zgjedhore në ambiente të institucionit, në këtë rast të Komunës së Obiliqit, e që përben shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartcekur të rregullës zgjedhore.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, se ky postim është fshirë menjëherë brenda sekondave të para, sapo është vërejtur gabimi, mirëpo këtë pretendim paneli e vlerëson si të pa bazuar, ngase e njëjta nuk e ka provuar në pretendim të tillë me asnjë provë të vetme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.290/2025, datë;03.02.2025

Kryesues i Panelit
Hariz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.